



Pranuar / Dorezuar Primjenol/Prodato Received/Delivery	09.03.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHUK	2593/2023		1/5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.33/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.33/2023 të datës 10.01.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_, kundër organit të punësimit-Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 09.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.33/2023 e datës 10.01.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. Detyrohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të nxjerr akt administrativ për njohjen e stazhit të siguruar, ankuesit si në piken 1 të këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civil ..... i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 10.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 105/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr. 33/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes me numër protokoll 1281 të datës 05.12.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, përmes të cilës i është refuzuar kërkesa për njohjen e të drejtës në stazhin e benificuar sipas dispozitave të ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Këshilli*) konform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 12.01.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 17.01.2023 ka përcjell përgjigjen se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës lidhur me këtë çështje juridike-administrative.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.02.2023 me Vendimin me numër protokoll 1946/2023 ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për dhjetë (10) ditë pune, lidhur me ankesën A.nr.33/2023 e datës 10.01.2023, të parashtruar nga ankuesi

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (tutje referuar vetëm Kolegji i Këshillit), pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritori administroi këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 105/2023 të datës 10.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 16.11.2022 të ankuesit për Vërtetimin me numër protokoll 180 të datës 23.11.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore; Ankesën e datës 24.11.2022; Përgjigjen me numër protokoll 1218 të datës 05.12.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokoll 230/2023 të datës 12.01.202; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 415/2023 të datës 17.01.2023 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar të datës 29.07.2019; Vendimin me Nr.prot:1946/2023 të datës 21.02.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton së ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, rrjedhimisht i njëjti sipas Kontratës së punës për kohë të pacaktuar të datës 29.07.2019 ushtron pozitën e punës se *Udhëheqësit të Pavijonit* në Qendrën Korrektuese në Dubravë.

Ankuesi më datë 16.11.2022 i është drejtuar njësisë përgjegjëse brenda organit të punësimit, gjegjësisht Njesisë së Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, më kërkesë për lëshimin e vendimit lidhur me përvojën e punës në këtë institucion, ndërsa, Menaxheri i Burimeve Njerëzore në organin përkatës të punësimit, më datë 23.11.2022 ka lëshuar Vërtetimin me numër protokoll 180 përmes të cilit ka konstatuar se ankuesi ka themeluar marrëdhënie pune prej datës 14.01.2002 dhe ka në tërësi 20 vite e 10 muaj e 9 ditë përvojë pune në këtë institucion.

Ankuesi më datë 24.11.2022 parashtron ankesë te Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me pretendimin se nga viti 2010 deri në vitin 2022 ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-191 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale sipas të cilit Zyrtarëve Korrektues për shkak të rrezikshmërisë për 12 muaj pune i llogariten 16 muaj stazh i siguruar.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, përmes Përgjigjes me numër protokoll 1281 të datës 05.12.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e njoftuar të njëjtin se nuk ka pasur akt nënligjor të miratuar nga ministri lidhur me këtë çështje pasi edhe ligji e ka paraparë këtë.

Ankuesi, kundër Përgjigjes me numër protokoll 1281 të datës 05.12.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me kërkesë që kjo e fundit të detyroje organin e punësimit për njohjen edhe të katër (4) viteve përvojë pune në emër të stazhit të siguruar sipas dispozitave të aplikueshme, respektivisht dispozitave të Ligjit Nr.03/L-191 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si dhe Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Kolegji i Këshillit për vendosje meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, analizoi bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore dhe si rrjedhojë konstatoi së Kuvendi i Republikë së Kosovës me 20.07.2010 ka miratuar Ligjin Nr.03/L-191 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, ku me nenin 214 paragrafi 7 dhe 8 të njëjtit ligj përcaktohej se: *"7. Personeli Korrektues i Shërbimit Korrektues, për shkak të rrezikshmërisë, rëndësisë, si dhe kushteve të veçanta të punës, për çdo dymbëdhjetë (12) muaj pune i llogaritet si gjashtëmbëdhjetë (16) muaj stazh i siguruar, kurse në llogaritjen e pagave sigurohet një shtesë e të ardhurav. 8. Kategorizimi i personelit, të cilët do të realizojnë beneficionet e parapara në paragrafin 7 të këtij neni rregullohet me akt të veçantë nënligjor të cilën e harton Shërbimi Korrektues dhe aprovon Ministria e Drejtësisë. Rrjedhimisht edhe me miratimin e Ligjit Nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (i zbatueshëm nga data 13.09.2013) është përcaktuar e drejta e stazhit të siguruar për zyrtaret korrektues, me çrast me nenin 221 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji përcaktohej se: "1. Zyrtaret korrektues, për shkak të rrezikshmërisë, rëndësisë, si dhe kushteve të veçanta të punës, për çdo dymbëdhjetë (12) muaj pune i llogaritet si gjashtëmbëdhjetë (16) muaj stazh i siguruar, kurse në llogaritjen e pagave sigurohet një shtesë e të ardhurave. 2. Kategorizimi i zyrtarëve korrektues, të cilët do të realizojnë beneficionet e parapara me paragrafin 1 të këtij neni rregullohen me akt të veçantë nënligjor të cilin e nxjerr Ministri".*

Kolegji i Këshillit nga administrimi i provave të lëndës nuk ka gjetur ndonjë akt nënligjore për rregullimin e procedurës lidhur me përfitimin e stazhit të siguruar të personelit korrektues, dhe për pasojë është vërejtur se personeli korrektues nuk kishte realizuar këtë të drejtë ligjore për periudhën e njohur nga legjislacioni në fuqi.

Mirëpo, përderisa dispozita e nenit 214 paragrafi 7 e Ligjit Nr.03/L-191 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (*i palakueshëm në periudhën 08.09.2010 - 12.09.2013*) dhe dispozita e nenit 221 paragrafi 1 e Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (*i aplikueshëm në periudhën 12.09.2013-25.08.2022*), i referohet "Zyrtareve korrektues", duke përcaktuar në mënyrë shprehimore se Zyrtaret korrektues, për shkak të rrezikshmërisë, rëndësisë, si dhe kushteve të veçanta të punës, për çdo dymbëdhjetë (12) muaj pune i llogaritet si gjashtëmbëdhjetë (16) muaj stazh i siguruar, kurse në llogaritjen e pagave sigurohet një shtesë e të ardhurave, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, mungesa e një akti nënligjore nuk mund të merret si bazë për mohimin e një të drejtë të fituar me ligj, ngase me aktin nënligjor, vetëm do të mund të bëhej kategorizimi i zyrtareve korrektues përfitues të kësaj të drejte, por jo edhe ndryshimi i standardit të përcaktuar me ligj, gjegjësisht standardit se zyrtarit korrektues për çdo dymbëdhjetë (12) muaj pune i llogaritet si gjashtëmbëdhjetë (16) muaj stazh i siguruar.

Andaj, meqenëse nga shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesi sipas ligjit në fuqi e ka statusin e zyrtarit korrektues, dhe duke marr parasysh se me dispozitat e aplikueshme ligjore është përcaktuar në mënyrë shprehimore e drejta e stazhit të siguruar për zyrtaret korrektues, dhe për pasojë nuk ka ndonjë akt nënligjor me të cilin pozita e ankuesit është përjashtuar nga e drejta e përfitimit të stazhit të siguruar për shkak të nivelit të përgjegjësisë, Kolegji i Këshillit vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për njohjen e të drejtës së stazhit të siguruar është i drejt dhe i bazuar.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit konstaton së ankuesi në cilësi të zyrtarit korrektues ka të drejtë në stazhin e siguruar për periudhën kohore nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.03/L-191 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, gjegjësisht nga data 08.09.2010, deri në ditën e shfuqizimit të Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, me datë 25.08.2022, dhe se njësia përgjegjëse në kuadër të organit të punësimit, në rastin konkret, udhëheqësi i Njesisë se Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, është i obliguar që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme juridike - administrative për njohjen e të drejtës së stazhit të siguruar, për ankuesin, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-191 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.79, me datë 24 Gusht 2010, si dhe Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.31, me datë 28 Gusht 2013.

Për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



**Këshillë juridike:** Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetari i Këshillit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.33/2023

**Avdyl Bekteshi**

*Avdyl Bekteshi*  
Procesmbajtës

**Jeton Koca**

*Jeton Koca*  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.